

Përmbajtja

PËEMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.	RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE.....	7
II.	MBIKËQYRJA POLICORE.....	21
III.	GARANTIMI I SIGURISË SË PERSONALITETEVE SHTETËRORE DHE OBJEKTEVE NË RUAJTJE.....	27
IV.	KONTROLLI DHE MBROJTJA E TERRITORIT.....	30
V.	PARANDALIMI DHE KUNDËRSHTIMI I FENOMENIT TË EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM.....	33
VI.	MBROJTJA NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI.....	38
VII.	PROGRAMET E VEÇANTA PËR FITIMIN E SHTETËSISË.....	41
VIII.	PRITJA DHE TRAJTIMI I AZILKËRKUESVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.....	42
IX.	SHËRBIMET E SHTËPISË SË PUSHIMIT.....	46
X.	REFERENCA.....	47

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ministria e Brendshme gjatë vitit 2023 ka vijuar me realizimin e prioriteteve dhe objektivave të synuar për garantimin e rendit dhe sigurisë publike, krijimin e një kulture inovative në ofrimin e shërbimeve për qytetarët, përmirësimin e kuadrit ligjor me një paketë ambicioze aktesh ligjore dhe nënligjore për një funksionim sa më efikas të strukturave të saj dhe në përputhje me rekomandimet e dhëna nga organizmat ndërkombëtarë.

Ministria e Brendshme krahas riorganizimit strukturor të disa njësive në varësi të saj gjatë këtij viti ka vijuar me vendosjen në funksion të strukturave të riorganizuara duke hartuar dhe miratuar një paket aktesh ligjore dhe nënligjore që lidhen me funksionimin dhe veprimtarinë e tyre, me synim përmirësimin e veprimtarive dhe aktiviteteve që kryhen në përmbushje të misionit për garantimin e sigurisë dhe rendit në vend dhe luftës kundër çdo forme të krimit të organizuar dhe fenomeneve të jashtëligjshme, përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe përmirësimin e shërbimit të shtetasve të huaj që për arsye të ndryshme si azili, migrimi etj. jetojnë në Shqipëri.

Gjithashtu edhe gjatë vitit 2023 vëmendje e veçantë i është kushtuar rritjes së nivelit të sigurisë në vend, sundimit të ligjit në të gjithë territorin, ngritjen e standardeve të punës në nivelet e vendeve të Bashkimit Evropian dhe përafrimin e legjislacionit me atë të vendeve Bashkimit Evropian.

Nëpërmjet intensifikimit të punës në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit është bërë e mundur:

Forcimi i luftës kundër krimit të organizuar e korrupsionit, forcimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimit efektiv me partnerët ndërkombëtarë dhe agjencitë e zbatimit të ligjit të vendeve të Bashkimit Evropian.

Forcimi i kontrollit të kufijve dhe përmirësimi i shërbimit në pikat e kalimit kufitar, për të bërë të mundur lëvizjen e lirë të njerëzve e mallrave dhe pritjen e flukseve migratore. Nëpërmjet marrëveshjes me FRONTEX, është forcuar siguria kufitare dhe bashkëpunimi operacional për parandalimin dhe goditjen e aktiviteteve kriminale ndërkufitare. Ky progres është vlerësuar dhe nga partnerët ndërkombëtarë.

Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, forcimi i kapaciteteve administrative e profesionale në PSH, ngritja e strukturave të posaçme të profilizuara për goditjen e grupeve dhe organizatave kriminale dhe sekuestrimin e aseteve burim krimi.

Vazhdimi pa ndërprerje i luftës ndaj kultivimit të bimëve narkotike, duke intensifikuar punën parandaluese e goditëse të rrjeteve të trafikimit dhe forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë në këtë drejtim.

Përmirësimi në fushën e qarkullimit rrugor, për krijimin e një kulture evropiane të lëvizjes. Përmirësimi i Kodit Rrugor në përshtatje me normat e vendeve të Bashkimit Evropian. Sensibilizimi i opinionit publik, ndërgjegjësimi i drejtuesve të mjeteve e këmbësorëve, duke përshtatur masat administrative me normat e transportit publik.

Implementimi i procesit të Policimit në Komunitet, si një filozofi partneriteti aktiv mes Policisë dhe Komunitetit për të denoncuar krimin dhe sjelljet anti-shoqërore. Për këtë qëllim janë miratuar aktet e domosdoshme për menaxhimin e kontrollit të territorit, përmes ndarjes në “zona policore”, krijimin e “zyrave të shërbimit policor” pranë njësive administrative dhe vendosja për herë të parë e oficerëve të sigurisë në shkollat publike.

Lehtësimi i procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve me standardet bashkëkohore, duke parandaluar fenomenin e korrupsionit në nivele të ndryshme.

Marrja e masave të rëndësishme për përmirësimin e infrastrukturës e logjistikës së Policisë së Shtetit, përdorimin e teknologjive bashkëkohore, ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe rritjen e standardeve të shërbimit.

Përmirësimi dhe lehtësimi i procedurave në ndihmë të qytetarëve, dixhitalizimi i shërbimeve të policisë, trajtimi financiar, ekonomik e logjistik i Policisë së Shtetit.

Vazhdimi i procesit të Vetingu-t, mbështetur në kuadrin ligjor të posaçëm të hartuar e monitoruar drejtpërdrejtë nga partnerët ndërkombëtarë.

**RAPORT I PERFORMANCËS VJETORE 2023 MBI
RENDIN, SIGURINË PUBLIKE, KUFIRIN,
MIGRACIONIN, AZILIN, SHTETËSINË, KONTROLLIN
DHE MBROJTJEN E TERRITORIT DHE MBROJTJEN
NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN**

I. RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

NIVELI I SIGURISË NË VEND SIPAS VEPRAVE PENALE KRYESORE

Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit gjatë periudhës janar- dhejtor 2023, janë angazhuar maksimalisht për të garantuar një mjedis të sigurt për komunitetin për të mbrojtur jetën dhe pronën, nga kërcënimet e krimit të organizuar dhe krimet e rënda, duke synuar gjurmimin dhe goditjen e grupeve e rrjeteve kriminale dhe pasurive të krijuara në mënyrë të paligjshme, si dhe duke bashkëpunuar ngushtësisht me të gjithë aktorët në fushën e sigurisë, agjencitë e sigurisë publike, komunitetin si dhe subjekte të tjera publike dhe private.

Treguesit e veprave penale të ndodhura në vend për vitin 2023 dëshmojnë një rritje të lehtë **me 1%** krahasuar me vitin 2022. Në shkallë vendi janë evidentuar gjithsej **33,820 vepra penale** dhe janë **zbuluar 31,437 ose 93%** e tyre.

Krahasuar me një vit më parë rezulton se si pasojë e intensifikimit të masave në luftën kundër krimit, niveli i zbulueshmërisë është rritur me përafërsi **1%**.

Vepra penale rritur me 1%



Fuqia zbuluese rritur me 1%



Numri i personave të dëmtuar nga veprat penale këtë vit rezulton të jetë 17,021 nga 13,650 që kanë qenë në vitin 2022. Nga totali i të dëmtuarve 4981 janë të gjinisës femërore dhe 9450 të gjinisës mashkullore.


Numri i autorëve të implikuar në këto aktivitete kriminale është 33,470 autorë, prej të cilëve janë arrestuar në kushtet e flagrancës 6585, janë ndaluar 1317 autorë, 23,753 ndiqen në gjendje të lirë dhe 1724 janë larguar.

Krimet e rënda kundër personit


Evidentuar gjithsej **290 vepra penale kundër personit**, nga të cilat janë **zbuluar 275** ose **95% e tyre**. Në krahasim me vitin e mëparshëm kanë ndodhur 7 ose **7% vepra penale më pak**.

Numri i autorëve të implikuar në këto vepra penale është më i lartë, nga 375 autorë të implikuar në vitin 2022 në **395** autorë të implikuar gjatë viti 2023. Si rezultat i punës së strukturave të Policisë së Shtetit dhe i bashkëpunimit të ngushtë me agjencitë dhe institucionet e tjera ligjzbatuese, numri i autorëve të arrestuar në falgrancë ka shënuar një tregues pozitiv gjatë viti 2023, me **14 autorë të arrestuar në flagrancë më shumë** se në vitin 2022, nga 190 autorë të larguar në 204.

Gjatë viti 2023 janë shënuar **19% vrasje me dashje më pak** se në vitin 2022. Janë evidentuar **35 vrasje me dashje** dhe janë zbuluar 80% e tyre, ndërsa gjatë viti 2022 janë shënuar 43 vrasje me dashje, dhe janë zbuluar 72%.



Tendenca e kriminalitetit sipas qarqeve: Qarku i Tiranës është qarku në të cilin kanë ndodhur pjesa më e madhe e veprave penale edhe për vitin 2023, ndërsa Qarku i Kukësit është qarku me numrin më të vogël të veprave penale të evidentuara gjatë vitit 2023 duke vijuar në të njëjtën renditje edhe në raport me vitin e kaluar.




Dhuna në familje

Janë evidentuar **1,911 vepra penale në familje** dhe janë zbuluar në masën **100 %**.

Në raport me vitin 2022 kanë ndodhur 25 raste më shumë e veprave penale në familje, duke shënuar rritje me 1.3%. Janë trajtuar me kërkesë-padi “*Për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes/Urdhrit të Mbrojtjes*”, 2,730 raste të dhunës në familje duke shënuar rënie me 7.6% në raport me vitin 2022 ose 210 raste më pak të trajtuara me urdhër mbrojtje.

DHUNA NË FAMILJE NENI 130/a




Trafikët e paligjshme

Numri i trafikëve të paligjshme gjatë vitit 2023 ka shënuar rënie me 12%. Janë evidentuar në total **539 vepra penale** dhe janë zbuluar **99%** e tyre.

Tendenca e veprave penale në fushën e trafikëve të paligjshme vijon të mbetet në të njëjtën renditje: *trafikim i mjeteve motorike* (184), *ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit* (154), *krime në fushën e prostitucionit* (114), *trafikim i armëve, municioneve dhe lëndëve plasëse etj.* (29), *trafikim i personave të rritur* (36), *trafikim i të miturve* (15) dhe *trafikim i veprave të artit* (7). Në këto vepra penale janë **implikuar 918 autorë**, nga të cilët 194 janë arrestuar, 55 janë ndaluar, 586 ndiqen në gjendje të lirë, 76 janë larguar dhe 7 të ndryshëm. Gjatë vitit 2023 numri i autorëve të implikuar në ngjarjet/rastete e trafikëve të paligjshme është rritur, me 14 autorë më shumë ose 1.5%.


TRAFIQET E PALIGJSHME



Krimet ndaj pronës dhe pasurisë

Evidentuar gjithsej **4,381 vepra penale kundër pasurisë**, nga të cilat janë **zbuluar 3,426 ose 78%** e tyre. Krahasuar me vitin e kaluar rezultojnë 99 vepra penale më shumë, duke shënuar **rritje me 2.3 %** të veprave penale kundër pasurisë. Nga veprat penale kundër pasurisë nuk është shënuar asnjë rast i vjedhjeve me pasojë vdekjen, ndër të tjerat sipas rëndësisë janë: vjedhje me armë 9, nga të cilat janë zbuluar 7 dhe vjedhje banke 1, e cila është zbuluar.

KRIMI NDAJ PRONËS & PASURISË




Evidentuar/zbuluar 2022-2023

Krimi kibernetik

Gjatë vitit 2023 janë evidentuar gjithsej **764 vepra penale**, nga të cilat janë **zbuluar 413 ose 54%** e tyre. Nga 764 vepra penale të evidentuara për krimin kibernetik, 538 janë për falsifikim dhe ndërhyrje kompjuterike, 135 janë vepra penale të kryera nëpërmjet mashtrimit kompjuterik dhe 91 vepra penale për pornografi me të mitur.

Në raport me vitin e kaluar janë evidentuar 219 vepra penale më shumë në fushën e krimin kibernetik, shprehur ndryshe është shënuar rritje me 40%.


KRIMI KIBERNETIK



Evidentuar/ zbuluar 2022- 2023

Siguria rrugore

Gjatë vitit 2023 numri aksidenteve rrugore pësoi rritje me 5.4% në raport me vitin 2022, kjo edhe si pasojë e shtimit të numrit të automjeteve në qarkullim. Studimi i të dhënave statistikore tregon se trendi i aksidenteve ka ardhur në rënie nga viti 2016 deri në vitin 2023. Ky trend ka ndryshuar vetëm midis vitit 2020 dhe 2021, ku theksojmë se situata është ndikuar nga masat kufizuese të qarkullimit rrugor, për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19. Gjatë vitit 2023 kanë ndodhur **1,228 aksidente**, me **192 të vrarë dhe 195 plagosur rëndë**. Për të evidentuar dhe për të dhënë një panoramë sa më reale të tendencës së aksidenteve rrugore, janë marrë në studim edhe vitet e mëparshme, duke nisur nga 2016. Nga të dhënat statistikore të pasqyruara në grafikun më poshtë rezulton se situata e aksidenteve në vend ka ardhur në përmirësim që nga viti 2016 dhe në vijim, me përjashtim të diferencës së shënuar midis vitit 2020 dhe 2021, të cilën e përmendëm dhe më sipër dhe gjatë vitit të fundit ku pati një rritje me 5.4%.




Në fushën e veprave penale të qarkullimit rrugor gjatë vitit 2023 janë evidentuar gjithsej **5548** vepra penale dhe janë **zbuluar 98%** e tyre për: “*drejtim i autojmetit në mënyrë të parregullt*” (3072), “*shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor*” (2154) dhe “*largim nga vendi i aksidentit*” (322). Krahasuar me një viti më parë veprat penale në fushën e sigurisë rrugore kanë shënuar **rënie me 2.3%, nga 5680 në 2022 në 5548 gjatë vitit 2023**.

Gjatë vitit 2023 janë vendosur **884,014 masa administrative**, duke shënuar **rritje me 18%** në raport me vitin 2022. Numri i masave administrative në pesë vjecarin e fundit ka ardhur duke u rritur. Ky tregues konsiderohet pozitiv pasi dëshmon rritjen e ndëshkueshmërisë për shkelësit e rregullave të qarkullimit rrugor.

Shkaqet kryesore të aksidenteve edhe për vitin 2023 lidhen me mos respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor, drejtimin e mjeteve në gjendje të dehur, tejkalimin e shpejtësisë përtej normave të lejuara, parakalimin e gabuar, përdorimin e celularëve, por edhe si pasojë e shtimit të numrit të automjeteve në qarkullim.

TENDENCA E VEPRAVE PENALE TË QARKULLIMIT RRUGOR



- Drejtimit i automjetit në mënyrë të parregullt
- Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor
- Largim nga vendi i aksidentit

Vepra penale në fushën e terrorizmit

Masat e marra për parandalimin e akteve terroriste dhe bashkëpunimi i ngushtë me shërbimet e inteligjencës dhe agjencitë ligjzbatuese në vend realizoi edhe për këtë vit mbajtjen në nivel të “ULËT” të kërcënimit edhe pse krahasuar me vitin 2021 janë shënuar 9 raste më shumë e veprave penale me qëllime terroriste. Gjatë vitit 2023 janë evidentuar gjitshej **38 vepra penale** të lidhura me qëllime terroriste në Shqipëri dhe janë zbuluar **74%** e tyre.


Gjatë vitit 2023 është miratuar dhe Strategjia ndërsektoriale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit për vitet 2023-2025, si dhe Plani i saj i veprimit 2023-2025.

LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR

Hetimet proaktive

Referimet për grupe kriminale të krimit të organizuar bazuar në hetimet proaktive **kanë rënë me 11% ose 169 hetime proaktive më pak** krahasuar me një vit më parë. Gjatë vitit 2023 janë ndjekur 1380 hetime proaktive prej të cilave:


- 270 në fushën e trafikeve të paligjshme;
- 327 në fushën e narkotikëve;
- 318 për pastrim të produkteve të veprës (Neni 287 I K.P.);
- 398 në fushën korrupsionit dhe krimeve në detyrë;
- 40 në fushën e krimit ekonomik e financiar;
- 11 në fushën e krimeve ndaj personit e pasurisë;
- 16 në fushën e krimeve kompjuterike;



Operacione policore kundër krimit të organizuar


Janë zhvilluar gjithsej **105 operacione policore**, prej të cilave 51 janë zhvilluar në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar. Më poshtë operacionet policore sipas fushave dhe bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtar.

- **40 operacione policore në fushën e krimit ekonomik – financiar**, 2 prej të cilave janë zhvilluar në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.
- **33 operacione policore në fushën e krimeve të rënda**, nga të cilët 32 në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.
- **29 operacione në fushën e narkotikëve**, 16 prej të cilave janë zhvilluar në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.
- **3 operacione policore në fushën e krimit kompjuterik**, 1 prej të cilëve zhvilluar në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.



Grupe kriminale të goditura dhe vepra penale të referuara për grupet kriminale

Në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar gjatë vitit 2023 janë goditur pjesërisht gjithsej **30 grupe kriminale** nga 28 grupe kriminale të goditura vitin e kaluar duke shënuar rritje me 7.1%. Nga grupet kriminale të evidentuara gjatë vitit 2023, 13 prej tyre janë goditur pjesërisht pasi janë arrestuar një pjesë e anëtarësisë së tyre. Nga të dhënat rezulton se pjesa më e madhe e grupeve kriminale është me aktivitet në fushën e narkotikëve. Më poshtë grupet kriminale të renditura sipas aktivitetit kriminal.



Janë evidentuar gjithsej **17 vepra penale** dhe janë **zbuluar 94%** e tyre për goditjen e grupeve të strukturuar kriminale dhe organizatave kriminale. Në krahasim me vitin e kaluar është evidentuar 1 vepër penale më pak.


Asete të sekuestruara nga veprimtaritë kriminale

Në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar edhe gjatë vitit 2023 ka vazhduar sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive të vendosura si pasojë e veprimtarive kriminale.

Gjatë vitit 2023 vlera e aseteve të sekuestruara për veprën penale të pastrimit të parave ka qenë 23,383,230 Euro dhe vlera e aseteve të sekuestruara sipas *ligjit antimafia* ka qenë 48,345,082 Euro pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.

Në grafikun më poshtë është pasqyruar situata e sekuestrimit të aseteve midis dy viteve, për vlerat e aseteve të sekuestruara në Euro sipas *nenit 287 të Kodit Penal për pastrimin e parave* dhe vlera e aseteve të sekuestruara në Euro sipas *Ligjit Antimafia*.

VLERA E ASETETEVE TË SEKUESTRUARA NË EURO 2022-2023




Kultivimi dhe trafikimi i lëndëve narkotike

Policia e Shtetit ka vijuar punën për realizimin e objektivave, me synim goditjen e grupeve dhe rrjeteve të trafikimit dhe kultivimit të drogave dhe bimëve narkotike. Ka vijuar puna e përbashkët me partnerët ndërkombëtar, për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike, identifikimin, zbulimin dhe shkatërrimin e grupeve dhe rrjeteve kriminale në fushën e kultivimit dhe trafikimit të kanabisit.

Në fushën e narkotikëve e trafiqeve të paligjshme, gjatë vitit 2023 janë evidentuar 2981 vepra penale, janë zbuluar 2933 ose 98% e tyre. Janë proceduar penalisht 4495 persona, janë arrestuar/ndaluar 2081, hetohen në gjendje të lirë 2609 dhe janë shpallur në kërkim 254 persona.


VEPRA PENALE NARKOTIKËT EVIDENTUAR & ZBULUAR



Korrupsioni

Gjatë vitit 2023 janë evidentuar gjithsej **928 vepra penale** për korrupsion, nga të cilat janë **zbuluar 830** ose **90 %** e tyre.

Në krahasim me vitin e kaluar rezultojnë 264 vepra më pak ose shprehur ndryshe është shënuar rënie me 22% e veprave penale në fushën e korrupsionit.



Janë implikuar **1138 autorë** në vepra të ndryshme penale për korrupsion dhe janë arrestuar 107 prej tyre, 71 janë ndaluar dhe 943 ndiqen në gjendje të lirë, etj.

MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT DHE MIGRACIONIT

Në zbatim të Programit Vjetor të Policisë së Shtetit për vitin 2023, Strategjisë Ndër-sektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027 dhe Planit të Veprimit 2021-2023, Departamenti për Kufirin e Migracionin (DKM) e ka përqendruar punën në përsosjen e komponentëve të Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe rritjen e standardeve të sigurisë kufitare, nëpërmjet kontrollit efektiv, parandalimit e goditjen e krimit ndërkufitar, rritjes së kapaciteteve dhe aftësive profesionale për menaxhimin e migracionit dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar sipas standardeve të Bashkimit Evropian.


3.1 Hyrje –daljet në kufi

Gjatë vitit 2023 në Pikat e Kalimi e Kufitar janë evidentuar **në hyrje - dalje 33,685,793 shtetas** shqiptarë dhe të huaj në total, duke shënuar rritje me 16% krahasuar me vitin 2022, si dhe janë regjistruar në hyrje-dalje 9,123,127 automjete ose 10 % më shumë se viti i kaluar.

3.2 Shtetas në kërkim të kapur në kufi

Gjatë vitit 2022 janë kapur në kufi 555 shtetas në kërkim, nga të cilët 395 në kërkim kombëtar, 29 në kërkim ndërkombëtarë dhe 131 për autoritetet e Kosovës. Nga të dhënat statistikore rezulton se gjatë vitit 2023 janë kapur 56 shtetas në kërkim më shumë krahasuar me vitin e mëparshëm.

SHTETAS NË KËRKIM TË KAPUR NË KUFİ




3.3 Kalim i paligjshëm i kufirit

Janë kapur **268 shtetas** shqiptar në tentativë **për kalim të paligjshëm të kufirit**, 28 % më pak ose ndryshe 104 shtetas më pak se gjatë vitit 2022. Kjo rënie ka ardhur si rezultat i shtimit të patrullave nga shërbimet e policisë kufitare dhe shërbimet e FRONTEX në kuadër të forcimit të kontrollit të kufirit të gjelbër.

Mbi faktin e forcimit të kontrollit të kufirit të gjelbër është rritur dhe numri i ndëshkimeve me masa administrative të shtetasve shqiptarë me 977 raste, kryesisht për kalim të paligjshëm të kufirit dhe shtetasve të huaj në 263 raste për shkelje të afateve të qëndrimit në territor.


Një vëmendje e shtuar i është kushtuar edhe kontrolleve në vijën e dytë të automjeteve. Gjatë vitit 2023 janë kryer 700 344 kontrolle të automjeteve në vijën e dytë ose 346 824 më shumë se një vit më parë, rritje me 50%.

SHTETAS NË KËRKIM TË KAPUR NË KUFİ



3.5 Imigrantë në Republikën e Shqipërisë

Gjatë vitit 2023 nga shërbimet e DVKM, janë kapur **6 630** shtetas të **huaj imigrantë të parregullt**, prej të cilëve 4 781 për herë të parë dhe 1 849 përsëritës. Krahasuar me një vit më parë janë 5 301 shtetas më pak ose 44 %. Kjo ulje lidhet me forcimin e kontrollit të kufirit të gjelbër sidomos në zonën operacionale Kakavijë/ Qaf Botë/Kapshticë ku janë të dislokuar edhe forcat FRONTEX.



Numrin më të lartë të imigrantëve të kapur e zënë shtetas nga Afganistani, pastaj renditen ata nga, Siria, Bangladeshi, Pakistani, e Iran që këtë vit kanë pësuar rënie të ndjeshme.

Tendenca në ulje e numrit të imigrantëve të parregullt drejt vendit tonë vjen si rezultat dislokimit të forcave FRONTEX në territorin e DVKM-ve Korçë, Gjirokastrë dhe Vlorë)

Pikat kryesore të hyrjes së tyre në Shqipëri janë në kufirin e Sarandës, Korçës dhe Kakavijës, pasi afër Janinës e Selanikut janë ngritur kampe imigrantësh të parregullt.


3.4 Menaxhimi dhe trajtimi i të huajve në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe trajtimi i kërkesave për vizë

Gjatë vitit 2023 janë regjistruar **12,436 aplikime për leje qëndrimi** ose 2289 (18.4%) aplikime më shumë se gjatë vitit 2022. Nga totali i aplikimeve, 8145 janë aplikantë meshkuj dhe 4291 aplikantë femra. Statusi i aplikimeve për leje qëndrimi gjatë vitit 2023 është si më poshtë.

- në Proces 2081;
- refuzuar 591;
- leje Qëndrimi të lëshuara 9795 leje.

Për sa i përket shtetësive edhe gjatë këtij viti dominon ajo Italiane me 2198 shtetas, më pas ndiqet nga Kosova me 1347 shtetas, Turqia me 1135 shtetas dhe Indi me 856 shtetas, etj.

APLIKIME PËR LEJE QËNDRIMI



FORCIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRINSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR

Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit kanë synuar drejt rritjes së nivelit të bashkëpunimit me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në vend si dhe me partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht për kryerjen e operacioneve të përbashkëta për të luftuar krimin e organizuar dhe trafiqet.

Në zbatim të Marrëveshjes Statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian “Mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë” dhe Planit Operacional “Multipurpose Operational Activities in Albania”, ka vazhduar deri në janar të vitit 2024 Operacioni i përbashkët me FRONTEX “JO Albania Sea 2023” në kufirin detar.

PKM në bashkëpunim me institucionet pjesëmarrëse të QNOD, kanë organizuar, koordinuar dhe drejtuar 62 operacione, si më poshtë:

- 1 operacion detar kundër trafikut të lëndëve narkotike.
- 18 operacione detare për kontroll dhe mbikëqyrjen e kufirit.
- 38 operacione detare për dhënie ndihmë në det dhe SAR.
- 1 operacion detar për kontrollin dhe zbatimin e ligjshmërisë në det dhe sigurinë lundrimore.
- 1 operacion detar për kontrollin e zbatimit të ligjit fiskal doganor.
- 3 operacione detare për parandalimin nga ndotja dhe mbrojtjen e mjedisit.

Krahasuar me 2022 janë zhvilluar 5 operacione më pak si rezultat i masave të marra për forcimin e kontrollit të kufirit detar dhe bashkëpunimit me Frontex, GdF dhe Agjencitë e tjera ligj zbatuese.

Nga strukturat e PKM-së janë zhvilluar 11 operacione të përbashkëta në det në bashkëpunim me Guardia di Finanza, Rojen Bregdetare, FRONTEX dhe Policinë Kufitare të Malit të Zi, për kontrollin e kufirit, kundër trafikut të narkotikëve dhe kontrabandës së naftës, i njëjti numër me vitin 2022.

Në kuadrin e zbatimit të protokolleve për patrullimet e përbashkëta gjatë këtij viti janë kryer 1125 patrullime të përbashkëta me punonjësit e policisë kufitare të vendeve fqinje nga të cilët 306 me Malin e Zi, 181 me Maqedoninë, 214 me Kosovën dhe 424 me Guardia di Finanzën.

Krahasuar me 2022, janë realizuar 149 patrullime më shumë ose e shprehur në përqindje 15 % më shumë.

II. MBIKËQYRJA POLICORE

Veprimtaria e strukturave të Shërbimit përgjatë vitit 2023, krahas përpjekjeve për të realizuar dhe përmbushur misionin dhe e objektin e veprimtarisë së saj në kuadër të implementimit të ligjit organik të Agjencisë dhe ligjit për vetingun përgjatë vitit 2023, janë draftuar e miratuar akte ligjore e nënligjore të kompetencës së Këshillit të Ministrave, Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm, si më poshtë:

- Ligji nr. 49/2023, datë 22.06.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar...”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 321, datë 31.05.2023 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 772, datë 13.12.2023 “Për disa të drejta të punonjësve të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Brendshëm me ILDKPKI nr. 15, datë 27.01.2023 “Për miratimin e Formularëve të Deklarimit të Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik....”;
- Udhëzimet e Ministrit të Brendshëm nr. 06 dhe 07, datë 17.01.2023 “Për miratimin e formularëve të deklarimit të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale për vlerësimin kalimtar dhe periodik” dhe “për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet sipas ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar”.

Rritja dhe forcimi i kapaciteteve të brendshme të Agjencisë

Në kuadër të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve të brendshme të Agjencisë, nëpërmjet bashkëpunimit me organizma të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit janë zhvilluar aktivitetet e mëposhtme.


- Trajnimi “Mbi procedurën e plotësimit dhe pranimit të deklaratave të nevojshme në kuadër të vlerësimit kalimtar dhe periodi
- Trajnimi për “Përdorimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit iBase (SMI Ibase)”.
- Trajnimi i personelit të Agjencisë “Për njohjen dhe zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm “Për procedurat e aplikimit dhe verifikimit për pajisjen me CSP të personelit të strukturave të Ministrisë dhe atyre në varësi të saj”,
- Trajnimi bazë 3 – mujor i 20 punonjësve në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë dhe Prokurorinë e Tiranës.
- Trajnimi i 48 punonjësve të Agjencisë, të organizuar nga ICITAP me temë “Intervistimi i viktimave, dëshmitarëve dhe të dyshuarve si dhe përdorimi i pajisjeve audiovizive të intervistimit”.
- Trajnimi 6 – javor i 2 drejtuesve të Agjencisë, të organizuar nga ICITAP me temë “Trajnues për hetimin e krimeve të lehta”, zhvilluar në ambjentet e Akademisë së Sigurisë.
- Takim pune në muajin Qershor 2023, ndërmjet Anëtarëve të Trupës Vlerësuese të Agjencisë me Këshilltarë të Komisionit të Pavarur Kualifikimit në kuadër të procesit të vetingut në Polici.

- Trajnimi 2-ditor në muajin Korrik 2023, i një grupi punonjësish nga Agjencia, me temë *“Etika, të Drejtat e Njeriut dhe Praktika Procedurale në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”* organizuar nga prezenca e OSBE-së në Shqipëri.
- Seminari 2 - ditor, në datat 2 – 3 Tetor 2023, me pjesëmarrjen e 1 përfaqësuesi të Agjencisë, organizuar nga projekti EU4LEA, në ambjentet e Akademisë së Sigurisë, me tematikë *“Monitorimi i realizimit të Planit të Integritetit të Policisë së Shtetit”*.
- Seminari 1 - ditor në 14 Nëntor 2023, me pjesëmarrjen e 5 punonjësve të Agjencisë së bashku me punonjës të Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit, me temë *“Balanca midis të Drejtës për Informim dhe Mbrojtje së Informacionit të Klasifikuar: Standardet Ndërkombëtare dhe Praktikën më mirë”*, organizuar nga CIDS.
- Trajnimi 1-javor në ILEA, Budapest, Hungari dhe pjesëmarrja e 4 punonjësve të Agjencisë, me temë *“Korrupsioni publik”* nga data 13 – 17 Nëntor, organizuar dhe financuar nga ICITAP.
- Pjesëmarrja në tryezën e diskutimit *“Ndarja e Përvojave në Reformimin e Policisë”*, organizuar nga IDM Albania.
- Pjesëmarrje jashtë vendit e 2 punonjësve të Agjencisë, në panairin *“Milipol”*, për t’u njohur me të rejat në fushën e teknikave dhe pajisjeve të përgjimit.
- Trajnim 6 – javor pranë Shkollës së Administratës Publike me pjesëmarrjen e 1 punonjësi të Agjencisë, me tematikë *“Për menaxhimin e investimeve, hartimin e fishe - projekteve dhe zbatimin e tyre”*.
- Trajnim në Akademinë e Sigurisë, nga data 19 – 20 Tetor 2023. me temë *“Llojet e rrjeteve sociale, forma, vjedhja e profileve, krijimi i profileve të rreme”* me pjesëmarrjen e 8 punonjësve të Agjencisë.

Mbikqyrja nëpërmjet Hetimeve Procedurale Penale

Janë **referuar në prokurori 249 raste** për vepra të ndryshme penale, për **416 subjekte**, nga të cilët **342 janë punonjës të strukturave dhe 74 shtetas**. Janë zbatuar vendime të gjykatave për masat e sigurimit personal si: *arrest në burg, arrest në shtëpi, pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik dhe detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore* për 141 persona, nga të cilët 2 punonjës policie niveli i mesëm drejtues, 28 punonjës policie të nivelit të parë drejtues, 60 punonjës policie niveli zbatues, 3 punonjës policie civil, 3 efektive i Gardes, 5 MNZSH-se dhe 40 shtetas.

REFERIME PENALE DHE AUTORË TË PROCEDUAR PENALISHT



Trendi i veprave penale për 249 referimet penale ndaj 342 subjekteve punonjës të strukturave janë si më poshtë:

- 87 referime ndaj 120 punonjës të strukturave dhe 14 shtetas për veprat penale të “shpërdorim detyre” & “korrupsioni pasiv”,
- 76 referime ndaj 124 punonjës të strukturave dhe 54 shtetas për veprën penale “shpërdorim detyre” duke favorizuar “forma të ndryshme të paligjshmërive”,
- 43 referime ndaj 45 punonjësve të strukturave dhe 2 shtetas, për veprat penale “dëmtime të tjera me dashje”, “dhunë në familje”, “goditje për shkak të detyrës”, etj,
- 27 referime ndaj 37 punonjësve të strukturave dhe 4 shtetas, për veprën penale të “kryerjes së veprimeve arbitrare”;
- 16 referime ndaj 16 punonjësve të strukturave për veprën penale “drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt” dhe “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”;

Edhe për vitin 2023, “shpërdorimi i detyrës” dhe “korrupsioni pasiv”, rezulton të jenë forma më klasike e paligjshmërive, e kryer qoftë si formë e vetme apo e gërshetuar me shkelje të tjera ligjore. Rastet e implikimit në format e paligjshmërisë të shprehura në % sipas grafikut më poshtë:

TRENDI I SHKELJEVE SIPAS VEPRAVE PENALE



Ky grafik reflekton pothuajse të njëjtën tendencë të formave dhe fenomeneve të paligjshmërisë të evidentuar ndër rradhët e strukturave si në vitet e mëparshme. Përqindjen më të lartë e zënë me 35 % të totalit rastet e përfshirjes në “korrupsion dhe shpërdorim detyre”, pasuar me 31% të totalit për kryerjen e veprave penale “shpërdorim detyre” duke favorizuar “forma të ndryshme të paligjshmërive”, 17% të totalit rastet e “dëmtimeve me dashje”, 11% të totalit rastet e “kryerjes së veprimeve arbitrare” dhe 6% të totalit rastet për “drejt看 mjeti në mënyrë të paligjshme”.

Mbikqyrja nëpërmjet Hetimeve Proaktive

Strukturat e Hetimit në nivel qendror e vendor me kompetenca të veprimtarisë parandaluese, gjatë veprimtarisë së tyre operative në kërkim të informacionit kriminal nëpërmjet burimeve të fshehta informative e jo vetëm, kanë grumbulluar të dhëna/informacione për implikim të mundshën në veprimtari të kundraligjshme të punonjësve të strukturave apo shtetasve. Gjatë këtij viti janë trajtuar dhe përpunuar gjithsej **363 informacione**, nga të cilat:

- 62 informacione për *“korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”*;
- 55 informacione për *“shpërdorim detyre duke favorizuar prodhimin dhe shitjen e narkotikëve”*;
- 54 informacione për *“shpërdorim detyre”*;
- 36 informacione për *“shpërdorim detyre duke favorizuar kultivimin e bimëve narkotike”*;
- 14 informacione për *“shpërdorim detyre duke favorizuar kalimin e paligjshëm të kufijve”*;
- 20 informacione për *“shpërdorim detyre duke favorizuar lojrat e paligjshme të fatit”*;
- 4 informacione për *“shpërdorim detyre duke favorizuar kontrabandën”*;
- 4 informacione për *“shpërdorim detyre duke favorizuar ndërtimet pa leje”*;
- 3 informacione për *“kontakt të papërshtatshëm”*;
- 2 informacione për *“vjedhje duke shpërdoruar detyrën”*;
- 1 informacion për *“falsifikim i vulave, stampave, etj”*.
- 13 informacione për *“të tjera”*.

Aktiviteti operativ i strukturave të Agjencisë, është fokusuar në ngritjen e proceseve informative nëpërmjet marrjes së të dhënave nga burimet e fshehta informative dhe përdorimit të metodave dhe teknikave speciale të hetimit parandalues, konkretisht janë:

Janë **në ndjekje 79 dosje të procesit informative**, të cilat sipas tendencës i klasifikojmë:

- 27 dosje për tendencën e *“shpërdorim detyre duke favorizuar prodhim dhe shitje narkotikësh”*;
- 20 dosje për tendencën e *“shpërdorimit të detyrës”*;
- 18 dosje për tendencën e *“korrupsionit pasiv”*;
- 5 dosje për tendencën e *“shpërdorim detyre duke favorizuar kultivimin e bimëve narkotike”*;
- 4 dosje për tendencën e *“shpërdorim detyre duke favorizuar kalimin e paligjshëm të kufijve”*;
- 2 dosje për tendencën e *“shpërdorim detyre duke favorizuar kontrabandën”*;
- 3 dosje për tendencën e *“shpërdorim detyre duke favorizuar organizimin e lojrave të paligjshme të fatit”*.

Mbikqyrja nëpërmjet hetimit administrative të ankesave dhe denoncimeve të publikut

Janë marrë **4203 telefonata** të publikut në **Linjën e Gjelbër** dhe 1522 ankesa të marra në nivel qendror dhe vendor. Nga hetimi administrativ i ankesave dhe kryerjes së inspektimeve ka filluar “Hetimi Disiplinor për Shkelje të Rënda të punonjësve të strukturave mbikëqyrëse” dhe Komisioni i Hetimit Disiplinor të Agjencisë për periudhën raportuese ka trajtuar gjithsej **94 praktika** dhe janë marrë **93 vendime, në ngarkim të 177 punonjësve**. Në përfundim të tyre është vendosur masa:

- *“Përrjashtim nga Policia” për 4 punonjës;*

- “shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 vjet” për 3 punonjës;
- “shtyrje e afatit të gradimit deri në 1 vit” për 10 punonjës;
- “shtyrje e afatit të gradimit deri në 6 muaj” për 22 punonjës;
- “mosfillimi i hetimit disiplinore” për 38 punonjës;
- “përfundimi i hetimit pa masë disiplinore” për 36 punonjës;
- “shkelje të lehtë” për 6 punonjës;
- “pezulluar hetimi disiplinor” për 14 punonjës;
- “dërgim praktike për kompetencë DPPSH-së” për 4 punonjës;
- “vazhdimi i hetimit disiplinor për shkelje të rëndë” për 3 punonjës;
- “kthyer për plotësim praktika hetimore disiplinore” është për 37 punonjës.

Nga ankesat e qytetarëve janë evidentuar shkelje të karakterit administrativ kryesisht në ato struktura që janë në vijën e parë të veprimit dhe në kontakt të drejtëpërdrejtë me publikun, siç janë strukturat e Sigurisë Publike, Policisë Rrugore apo Hetimit të Krimit të cilët janë më të rriskuar edhe në aspektin e veprimeve korruptive, të paraqitura si në grafikun e mëposhtëm.

Mbikëqyrja nëpërmjet CSP

Agjencia në cilësinë e një prej tre Autoriteteve Verifikuese në vend, sipas përcaktimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.188, datë 04.03.2015 “Për miratimin e Rregullave për Sigurimin e Personelit” ka organizuar dhe ndjekur punën për procesin e verifikimit të kushtit të sigurisë në kuadër të:

- aplikimit të personave për Certifikatë të Sigurimit të Personelit,
- procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve/prokurorëve sipas ligjit 84/2016
- procesit të rivlerësimit të strukturave sipas ligjit 12/2018, i ndryshuar
- procesit të verifikimit të kandidatëve për strukturat e reja të drejtësisë, sipas ligjit 96/2016.

Gjatë vitit 2023 janë trajtuar **11410 praktika për pajisje me Certifikatë të Sigurimit të Personelit**, për 5483 persona dhe 1670 punonjës të strukturave, objekt i veprimtarisë së Agjencisë. Në përfundim të procedurave verifikuese nga ana e Agjencisë, për punonjësit e strukturave, objekt i veprimtarisë së saj, janë adresuar me vlerësimin “që përbëjnë rrezik për pajisjen me CSP, në kuadër të aksesit dhe njohjes me informacionin e klasifikua “*Sekret Shtetëror*” 20 punonjës. Gjithashtu, gjatë vitit 2023 Agjencia është njoftuar për refuzimin/pezullimin/heqjen/ e CSP, për 19 punonjës, subjekte të Agjencisë.

Integriteti/Vettingu i subjekteve të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore

Procesi i Vettingut me të dy komponentët e tij atë të Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë, është një proces i rëndësishëm, qëllimi kryesor i të cilit është “dhënia e kontributi real për afirmimin e punonjësve profesionistë dhe me integritet të lartë të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, nëpërmjet zbatimit të parimit të integritetit, rritjes profesionale dhe

garantimit të një karriere të drejtë dhe të bazuar në meritokraci, duke krijuar në vazhdimësi institucione të forta dhe të besueshme”.

Më 5 Prill 2023, u zhvillua shorti i parë i ndarjes së trupave të vlerësimit si dhe i 36 subjekteve të listës së parë, në funksionet Drejtor Drejtorie në nivel qendror dhe vendor, ku 30 subjekte nga Policia, 4 subjekte nga Agjencia dhe 2 subjekte nga Garda e Republikës.

Më 4 Korrik 2023, u zhvillua shorti i dytë i ndarjes së trupave të vlerësimit si dhe i 36 subjekteve të listës së dytë, në funksionet Drejtor dhe Zv/Drejtor Drejtorie në nivel qendror dhe vendor, ku 30 subjekte nga Policia, 4 subjekte nga Agjencia dhe 2 subjekte nga Garda e Republikës. U administruan dosjet e subjekteve të listës së parë dhe të dytë dhe u dërguan formularët, respektivisht:

- i “deklarimit të pasurisë dhe dokumentacionit plotësues pranë ILDKPKI”;
- i “deklarimit të aftësive profesionale pranë burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës”;
- i “deklarimit të pastërtisë së figurës pranë Drejtorisë së Analizës & Sigurisë së Personelit së Agjencisë”.

Trupat Vlerësuese kanë zhvilluar **4 seanca** dhe **shqyrtuar rastet për 7 subjekte vlerësimi**, për të cilët është dalë me vendime konkrete:

- ✓ “konfirmim në detyrë” 3 punonjës;
- ✓ “ndërprerje e procesit të vlerësimit pasi pozicioni i tij/saj i punës është jashtë fushës së ushtrimit të institucionit të vlerësimit kalimtar” 2 punonjës;
- ✓ “largimin nga pozicioni objekt vlerësimi” 1 punonjës”;
- ✓ “shtyrje seance” 1 punonjës”

VENDIME "PROCESI I VETINGUT"



III. GARANTIMI I SIGURISË SË PERSONALITETEVE SHTETËRORE DHE OBJEKTEVE NË RUAJTJE

Garda e Republikës përgjatë vitit 2023 ka përmbushur me sukses misionin e saj në garantimin e sigurisë së personaliteteve dhe objekteve që ka në ruajtje, duke realizuar kështu të gjitha detyrimet ligjore e ato nënligjore që normojnë veprimtarinë e saj.

Një ndër arritjet e këtij viti ishte krijimi i një ambienti të sigurtë për realizimin e aktivitetit më të rëndësishëm që ishte ai i Samitit të Procesit të Berlinit dhe Ballkanit Perëndimor në Tiranë, i cili në llojin e tij organizohej për herë të parë jashtë kufijve të BE. Në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e vendit, të dedikuara për organizimin e Samitit, dhe sidomos me Policinë e Shtetit, Garda e Republikës siguroi 31 delegacione, pjesëmarrëse në Samit, gjatë të gjithë qëndrimit të tyre në vend. Për sigurinë e delegacioneve u angazhuan rreth 729 punonjës të të gjitha niveleve, nga të gjithë sektorët. Shërbimet e sigurisë të realizuara nga Garda përfshinë sigurinë e drejtpërdrejtë fizike të liderëve që morën pjesë në Samit, së bashku me delegacionet shoqëruese gjatë gjithë lëvizjeve të tyre, që prej pritjes në PKK e deri në largimin nga Shqipëria, në rrugë tokësore apo ajrore, sigurinë e ambienteve si hotelet në të cilët u akomoduan delegacionet, sigurinë e piramidës në të cilën u zhvillua aktiviteti apo edhe të të gjithë ambienteve të tjera përreth perimetrit të vendzhvillimit të aktivitetit; kontrollin e eskortave me ekspertë xhenier dhe qen eksplozivkërkues përpara çdo nisjeje të tyre për të shoqëruar personalitetin e anëtarët e delegacioneve, sikurse kontrollin me pajisje xheniere dhe qen për identifikimin e pajisjeve eksplozive në ambientet përreth kryerjes së Samitit. Aktivitetet të tjera të rëndësishme për sigurinë e të cilave është angazhuar Garda e Republikës gjatë vitit 2023 janë si më poshtë:

- Takimi i Ministrave të Turizmit të Rajonit;
- Takimi i Kryetarëve të Gjykatës së Lartë;
- Takimi i Ministrave të Energjitikës të Rajonit. Takimi i Kryeministrave të Rajonit; Samiti i Ministrave të Brendshëm;
- Samiti i Ministrave të Financave;
- Samiti i Ministrave të Jashtëm; Samiti i Diasporës; Samiti i Kryetarëve të Gjykatave Kushtetuese.

Gjatë muajve Tetor-Dhjetor shërbimet e Gardës kanë përballuar me sukses situatat tepër të tensionuara të krijuara nga deputetë e opozitës shqiptare, gjatë punimeve në seancat plenare dhe mbledhjeve të komisioneve parlamentare, të cilat u shoqëruan me konfrontime të drejtpërdrejta fizike, psikologjike e shpeshherë mediatike kundrejt insitucionit dhe punonjësve.

Sa i përket kuadrit ligjor, ai u plotësua me aktet nënligjore të lëna për zbatim në Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2023”. Konkretisht u miratuan plot shtatë akte nënligjore, çka nënkupton plotësimin e thujtë 98% të të gjithë kuadrit ligjor që normon veprimtarinë e Gardës së Republikës. Miratimi i këtyre akteve sjell jo vetëm plotësimin detyrues të

thjeshtë të praktikës ligjore por sjell edhe përmirësim të trajtimit financiar të punonjësve sikurse edhe shtimin e kompetencave dhe përgjegjësi të institucionit si një organ publik i besueshëm i zinxhirit të ofrimit e garantimit të sigurisë në vend. Në fillim të vitit, janar 2023, u krye implementimi i strukturës së re të Gardës, miratuar me Urdhër nr. 252, datë 30.12.2022 të Ministrit të Brendshëm *“Për miratimin e strukturës, organikës dhe përcaktimin e gradave korresponduese për çdo funksion në Gardën e Republikës së Shqipërisë”*. Me miratimin e VKM nr. 809 dhe 810 Garda e Republikës merr në ruajtje edhe objektet: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Autoriteti Kombëtar për Certifikimin elektronik dhe Sigurinë Kibernetike. Gjithashtu, u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 201, datë 07.04.2023, *“Për përcaktimin e procedurave të trajtimit me ushqim gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të Gardës së Republikës së Shqipërisë”* solli që çdo punonjës Gardë të përfitojë 556 lekë në ditë për trajtimin me ushqim, ndërsa Njësia Speciale 664 lekë në ditë për trajtimin me ushqim dhe u realizua rritja e pagave për punonjësit e Gardës, ku përfituan në total 1421 punonjës të të gjitha niveleve, pagat e të cilëve pësuan rritje në masën 10,4 % për punonjësit e nivelit bazë dhe në masën deri në 7.1 % për punonjësit e nivelit të mesëm, të lartë dhe madhor.

Në aspektin e baskëpunimit ndërinstitucional me partnerë ndërkombëtar gjatë vitit 2023 u nënshkrua Marrëveshja e Mirëkuptimit me Karabienierinë Italiane, një prej intitucioneve elitë të Europës Perëndimore në ofrimin dhe garantimin e sigurisë. Kjo marrëveshje synon të forcojë bashkëpunimin mes dy institucioneve në fushën e trajnimit, në përputhje me procedurat standarde ndërkombëtare dhe shkëmbimin e praktikave më të mira në lidhje me detyrat institucionale.

Disa tregues të performancës së shërbimit të Gardës së Republikës

Misioni i Gardës dhe vetë objekti i punës lidhen ngushtësisht me sigurinë e personaliteteve dhe objekteve në ruajtje. Viti 2023 ka patur të veçantat e veta në aspektin e objektivave e prioriteteve, për ngarkesën e konsiderueshme që e ka karakterizuar dhe performancën cilësore të realizimit të shërbimeve, veçanërisht të atyre të kryera mbi kohën normale të punës e mbi të gjitha të atyre me përgjegjësi të lartë. Gjatë këtij viti janë kryer 2463 **kontrolle** kundrejt 1549 të kryera në 2022.


Gjatë vitit 2023 janë kryer: 250 **shërbime për sigurinë e Presidentit të Republikës**; 183 për sigurinë e Kryetarit të Kuvendit, 516 për sigurinë e Kryeministrit të vendit; 249 për sigurinë e delegacioneve të huaja; 43 shërbime të përforcuara në Parlament gjatë zhvillimit të seancave plenare.

Nga sektori përgjegjës për **kryerjen e kontrollit xheniero-kimik** në objekte, ambiente të brendshme, automjete e të tjerë, para zhvillimit të çdo aktiviteti ku marrin pjesë personalitetet në ruajtje nga Garda, janë kryer në total për vitin 2023: 48 **kontrolle për sigurinë e Presidentit të Republikës**; 15 për sigurinë e Kryetarit të Kuvendit; 267 për sigurinë e Kryeministrit; 336 për sigurinë e delegacioneve të huaja; 30 për sigurinë e Personaliteteve Shtetërore; 40 për sigurinë e mbledhjeve të Seancave Plenare; 212 **kontrolle për sigurinë e seancave të zhvilluara nga KPK dhe KPA**; 1044 për sigurinë në ORV, rrugëkalime, automjete dhe 20 për përforcim shërbimi në ORV.

Gjatë vitit 2022 janë hartuar **559 plane operacionale** në zbatim të veprimtarive të personaliteteve, përkundrejt 596 planeve të hartuara në vitin 2022, ç’ka përkthehet në 37 shërbime sigurie të kryera


më pak në aktivitetet të zhvilluara nga Personalitetet e Larta Shtetërore dhe Personalitetet Shtetërore gjatë 2023.

PLANE OPERACIONALE PËR MBROJTJEN E PERSONALITETEVE



Garda krahas detyrave të përhershme në përmbushje të fushës së përgjegjësisë, kryen edhe shërbime sigurie në mbështetje të strukturave të tjera në rastet kur shihet e nevojshme. Në lidhje me këto detyrime, gjatë 2023 janë kryer 249 **shërbime sigurie për delegacionet e huaja**, 22 shërbime për eskortimin ceremonial të ambasadorëve gjatë dorëzimit të letrave kredenciale tek Presidenti i Republikës së Shqipërisë dhe 13 eskortime ceremoniale të personaliteteve të larta homologe. Sa i përket delegacioneve të huaja që janë siguruar gjatë vitit vlejné të përmenden se përveç personaliteteve masa sigurie janë marrë edhe gjatë zhvillimit të takimeve apo eventeve të rëndësishme si: *takimi i Ministrave të Turizmit të Rajonit, takimi i Kryetarëve të Gjykatës së Lartë; takimi i Ministrave të Energjitikës të Rajonit; takimi i Kryeministrave të Rajonit; Ministeriali i Ministrave të Brendshëm, Ministeriali i Ministrave të Financave, Ministeriali i Ministrave të Jashtëm, Samiti BE – Ballkani Perëndimor; Samiti i Diasporës dhe i Kryetarëve të Gjykatave Kushtetuese.*

SHËRBIME SIGURIE PËR DELEGACIONET E HUAJA



IV. KONTROLLI DHE MBROJTJA E TERRITORIT

Veprimtari e kryer në kuadër të mbështetjes së projekteve madhore të qeverisë

Gjatë vitit 2023 IKMT në kuadër të zbatimit të projekteve madhore të Qeverisë Shqiptare, ka ndërmarrë veprime duke proceduar deri në prishjen e 241 objekteve me apo pa leje sipas legjislacionit në fuqi, për realizimin e projekteve si më poshtë:

- 238 objekte/ndërtime janë prishur për lirimin e sheshit të ndërtimit për projektin infrastrukturor "Unaza e Madhe e Tiranës", në bashkinë Tiranë;
- 3 objekte në kuadër të realizimit të projektit "Rehabilitimi i Lumit Gjanica", "Rikonceptimi i Qendrës së qytetit" dhe "Ndërtimi i stadiumit të lojrave me dorë", bashkia Fier.

Veprimtaria e kryer për rehabilitimin e vijës bregdetare


Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, ka realizuar me sukses rehabilitimin e vijës bregdetare dhe zonave të mbrojtura duke proceduar deri në prishje të ndërtimeve dhe punimeve pa leje në territor, ku si rezultat i ndërhyrjeje janë prishur **23** objekte si më poshtë:

- 22 objekte të prishura për rehabilitimin e vijës bregdetare për sezonin turistik, në zonën bregdetare të qarkut Vlorë.
- 5 objekte të prishura për rehabilitimin e vijës bregdetare për sezonin turistik, në zonën bregdetare të qarkut Durrës.
- 1 objekt i prishur, për rehabilitimin e vijës bregdetare për sezonin turistik, në zonën bregdetare të qarkut Lezhë.
- 1 objekt i prishur për rehabilitimin e vijës bregdetare për sezonin turistik, në zonën bregdetare të qarkut Shkodër.

Veprimtaria e kryer në kuadër të projektit të rindërtimit objekteve në kundërshtim me ligjin dhe shpronësimeve

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit edhe gjatë vitit 2023 është angazhuar **për prishjen e objekteve dhe ndërtesave** përreth që çenojnë jetën e banorëve, në zonat **e prekura nga tërmeti** i 26 Nëntorit. Ky angazhim ka vijuar edhe për këtë vit duke prishur në total **2 objekte**. Gjithashtu gjatë vitit 2023 IKMT në përmbushje të misionit të saj për kontrollin dhe mbrojtjen e territorit ka realizuar prishjen e **370 objekteve** të ndërtuara në kundërshtim me ligjin dhe objekte të shpronësuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.

OBJEKTE TË PRISHURA NGA IKMT PËR VITIN 2023




Vendimet e IKMT

Gjatë vitit 2023, IKMT në kuadër të realizimit të detyrave dhe përmbushjes së përgjegjësisë të përcaktuara me ligj ka marrë gjithsej **438 vendime** si më poshtë:

- 2 vendime për “*Dënim me gjobë*” të vëna mbi zbatimin e ligjshmërisë tek produktet e ndërtimit/burimet ujore.
- 23 vendime për “*Dënim me gjobë*” të vëna ndaj kryeinspektorëve/inspektorëve pranë IMT-ve të bashkive për veprime/mosveprimet e tyre.
- 107 vendime për “*Dënim me gjobë*” të vëna në fushën e mjedisit, ujrave dhe pyjeve
- 123 vendime për “*Dënim me gjobë*” të vëna në fushën e ndërtimeve pa leje.
- 183 vendime për “*Prishje Objekti të Kundërligjshëm*” dhe “*Pezullimin e Punimeve në Ndërtim*”.


VENDIME IKMT PËR VITIN 2023



Inspektimet në territor

Trupa inspektuese e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit ka qenë e angazhuar në të gjithë territorin e vendit për kryerjen e kontrollit dhe inspektimeve sipas fushës së përgjegjësisë dhe ka kryer në total për vitin 2023, **3344 inspektime**.


INSPEKTIME TË KRYERA NGA IKMT PËR VITIN 2023



Drejtoritë Rajonale të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, kanë realizuar gjithsej **2837 inspektime**, nga të cilat:

- 849 janë realizuar në Fushën e Mjedisit dhe Burimeve Ujore.
- 987 janë realizuar në Fushën e Ndërtimit.
- 1001 janë realizuar në Pyje.

INSPEKTIME NGA DREJTORITË RAJONALE PËR VITIN 2023



Gjatë vitit 2023 nga Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave janë mbajtur 107 Vendime “Dënim me gjobë” dhe nga Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve janë mbajtur 44 vendime “Dënim me gjobë”.

V. PARANDALIMI DHE KUNDËRSHTIMI I FENOMENIT TË EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm përgjatë vitit 2023, ka vijuar realizimin e misionit të saj koordinues ndër-institucional në parandalimin dhe kundërshtimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm në zbatim të Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025, Planin e Veprimit 2023-2025 si dhe Planin e Përbashkët të Veprimit Kundër Terrorizmit në Ballkanin Perëndimor për vitet 2023-2024 si detyrim i vendit për përmbushjen e prioritetëve të përcaktuara për të luftuar terrorizmin me të gjitha format e shfaqjes së tij, si dhe nevoja e implementimit të objektivave që dilnin nga detyrimet ndërkombëtare të miratuara nga Këshilli i Sigurisë i OKB-së, Strategjinë e BE-së kundër terrorizmit dhe Konventën Evropiane dhe Protokollin shtesë të saj për parandalimin e terrorizmit, ku adresohet edhe fenomeni i luftëtarëve të huaj terroristë.

Aktiviteti është fokusuar në zbatimin e veprimtarisë së planifikuar në nivel qëndror dhe vendor në bashkëpunim me partnerë/aktorë të ndryshëm të shoqërisë për përmbushjen e objektivave të Planit të Veprimit në parandalimin e fenomenit kundër ekstremizmit të dhunshëm. Ka vijuar zbatimi dhe monitorimi i procesit të ri-integrimit të 37 (tridhjetë e shtatë) personave të riatdhesuar nga kampet e luftës, konkretisht për 13 (trembëdhjetë) shtetasit shqiptarë që u riatdhesuan më datë 27 maj 2022, 19 (nëntëmbëdhjetë) shtetasit shqiptarë të riatdhesuar më datën 1 gusht 2021 dhe 5 (pesë) shtetasit shqiptarë të riatdhesuar në 27 tetor 2020.

Gjatë vitit 2023 Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në koordinim me Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve të Njësisë Administrative përkatëse, psikologë dhe përfaqësues të Shërbimit Ligjor Falas, Drejtorisë së Antiterrorit dhe strukturave të Policimit në Komunitet, Rrjetin e Mësuesve Koordinatorë në nivel Kombëtar, Organizatat e Shoqërisë Civile, ka identifikuar dhe bashkërenduar punën për trajtimin e çështjeve që lidhen me radikalizmin, ekstremizmin e dhunshëm si dhe shfaqjen e fenomeneve të reja që janë hasur te personat e rikthyer nga ish zonat e konfliktit Siri dhe Irak, si në fazën e rehabilitimit ashtu edhe në atë të riintegritimit në komunitet.

Qendra me mbështjetjen e Fondit Global të Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë të Komunitetit, ka filluar punën për ngritjen e një qendre multidisiplinore në Tiranë për ofrimin e shërbimeve për fëmijët dhe familjet viktimë të ekstremizmit të dhunshëm. Gjithashtu, në bashkëpunim me Këshillin e Europës ka vijuar punën për ngritjen e Mekanizmit të Vlerësimit të Rrezikut në sistemin e burgjeve për çështjet e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm si dhe mekanizmin e vlerësimit para dhe pas daljes nga sistemi penitenciar.

Ka ndërmarrë përpjekje për të përmirësuar bashkëpunimin ndërsektorial mes strukturave të ndryshme, duke përfshirë zhvillimin e takimeve dhe tryezave të punës për diskutime rreth çështjeve të ngritjes së “Mekanizmit Kombëtar të Referimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm”.

Gjatë periudhës raportuese, QKEDH ka marr angazhimin për Rivitalizimin e rrjetit të “*Mësuesve Koordinator kundër ekstremizmit të dhunshëm*” nëpërmjet organizitës së Shërbimit Informativ të Shtetit dhe në partneritet me Linjën e Këshillimit për Gra dhe Vajza ka realizuar zhvillimin e takimeve informuese me 10 shkolla publike në zonën e Kombinatit, Kavajës, Shkodrës, Vlorës, përditësim të listës ekzistuese të mësuesve koordinator kundër ekstremizmit të dhunshëm nga të gjitha shkollat qëndrore, proces i cili u koordinua dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

Një tjetër angazhim kryesor i QKEDH-së ka qenë ngritja e kapaciteteve të rrjetit të *Oficerëve të Sigurisë në shkolla*, me qëllim rritjen e sigurisë dhe ndihmës në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në mjediset shkollore, duke ofruar një prani të sigurt dhe mbështetëse për nxënësit.

Një nga hapat kritikë të ndërmarrë nga QKEDH-ja në bashkëpunim me Sektorin përgjegjës për Policimin në Komunitet dhe Akademinë e Sigurisë, ka qenë ngritja dhe trajnimi i rrjetit të Shëfave të Rendit dhe Shëfave të Patrullës së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ky rrjet u krijuar për të përmirësuar aftësitë e zyrtarëve të policisë në identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në komunitet.

Tre shtyllat kryesore të punës së Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm ka qenë: *Parandalimi, Rehabilitim -Riintegrimi i të kthyerve nga zonat e konfliktit dhe Komunikimi Strategjik*.

Gjatë këtij viti QKEDH ka vazhduar me zbatimin e masave të planifikuara për të përmbushur objektivat e Planit të Veprimit në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025, gjithashtu, është fokusuar në procesin e rehabilitimit dhe ri-integrimit të shtetasve të riatdhesuar nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak nëpërmjet tre misionëve të riatdhesimit. Lidhur me rastet e identifikuar dhe të raportuara në institucionet përgjegjëse, QKEDH-ja ka koordinuar, zhvilluar dhe monitoruar takimet e GTN-së për secilin rast, ku është vlerësuar progresi i rasteve dhe nevojat e tyre pas vendosjes në komunitet. Në kontekstin e zbatimit të planit të ri-integrimit, gjatë periudhës vitit 2023, QKEDH ka koordinuar dhe zhvilluar 56 takime të Grupit Teknik Ndërsektorial për 12 familjet e riatdhesuara nga zonat e konfliktit Siri-Irak. Këto takime janë përqendruar në monitorimin, përmirësimin dhe sfidat që janë reflektuar nga këto raste gjatë kësaj periudhe, bazuar në Planet Individuale të Mbrojtjes të hartuara për këto familje nga Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijës e Njësisë Administrative ku janë vendosur, veçanërisht për fëmijët, si dhe hapat e ndërmarrë për integrimin e tyre në komunitet.

Në lidhje me procesin e ri-integrimit që po zbatohet me fëmijët e riatdhesuar nga zonat e konfliktit Siri-Irak, me koordinim të QKEDH, njëzet e katër fëmijë që janë në moshën shkollore kanë ndjekur procesin mësimor në shkolla me Plane Individuale të hartuara nga MAS dhe mësues mbështetës suportuar nga bashkëpunëtorët e QKEDH-së për të koordinuar këtë proces, lehtësuar procesin mësimor dhe krijuar kushtet e përshtatshme për ri-integrimin e tyre mësimor. Nga këta fëmijë, pesë po ndjekin arsimin e mesëm profesional në shkolla profesionale publike, një fëmijë po frekuenton një shkollë të mesme jo-publike me emrin “Tirana Jonë” dhe një fëmijë ndjek Liceun

Artistik Jordan Misja. Fëmijët më të vegjël kanë frekuentuar normalisht kopshtin dhe çerdhen. Gjithashtu, gjashtë prej fëmijëve të riatdhesuar kanë ndjekur kurset e gjuhëve të huaja në nivelet përkatëse. Me qëllim ri-socializimit të tyre, në koordinimin e QKEDH-së, gjashtë fëmijë po vazhdojnë të marrin pjesë në kurse rekreative, konkretisht pesë ndjekin kurse futbollit dhe një prej tyre frekuenton një kurs arti. Këto aktivitete janë mbështetur nga organizatat partnere TdH dhe Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza me mbështetjen e Fondi Global i Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë të Komunitetit. Me nisjen e vitit akademik 2023-2024, aktiviteti i QKEDH u përqendrua në koordinimin e organizatave partnere për të siguruar mësues mbështetës për të gjithë fëmijët që ndjekin procesin mësimor; gjithashtu edhe për pajisjen e tyre me materiale logjistike dhe didaktike. Me qëllim ri-integrimit dhe risocializimit të fëmijëve të riatdhesuar nga zonat e konfliktit në Siri-Irak, me koordinim të QKEDH, shtatë prej këtyre fëmijëve kanë marrë pjesë në kampet verore. Lidhur me procesin e ri-integrimit të një prej të miturve të riatdhesuar, i cili ka përfunduar arsimin e detyrueshme bazë por nuk ka zgjedhur të vazhdojë arsimin e mesëm, QKEDH i ka kushtuar një vëmendje të veçantë gjetjes së mundësive për një punësimi të ligjshëm me kohë të pjesshme për të. Në kuadër të zbatimit Planit të Veprimit 2023-2025, veçanërisht në lidhje me programet e rehabilitimit dhe ri-integrimit, fokusi kryesor i QKEDH është fuqizimi ekonomik i grave, nëpërmjet aftësimit profesional me qëllim punësimin në të ardhmen, dy prej grave kanë përfunduar kurse profesionale për rrobaqepësi dhe kuzhinë pranë Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Nr.1 Tiranë, me mbështetjen e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim një prej të rikthyerave është mbështetur për hapjen e një biznesi nga organizata Terres de Homme dhe për rastin tjetër është ofruar mbështetje për tu punësuar si rrobaqepëse pranë ndonjë kompanie me kohë të pjesshme për shkak të impenjimit me 4 fëmijët e saj. Gjithashtu një prej nënave të riatdhesuara ka përfunduar kursin profesional si operatore për përpunimin e të dhënave në fushën e kontabilitetit pranë një kompanie private dhe aktualisht është atashuar pranë një biznesi si ndihmës ekonomiste, në periudhë prove në procesin e intership-it të paguar për katër muaj për ti dhënë mundësi që të aftësohet sa më shumë pranë subjektit aktual ku po punon rasti.

Nën koordinimin e QKEDH-së, po zbatohen plani i ri-integrimit për të riatdhesuarit nga zonat e konfliktit, orientuar drejt asistencës direkte dhe të personalizuar, përmes së cilës QKEDH ndihmon në drejtimin dhe lehtësimin e punës së institucioneve të ndryshme të përfshira në këtë proces. Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje, ka arritur të ofrohet një gamë e gjerë e mbështetjes si më poshtë:

- Mbështetja për akomodim.
- Ofrimi i mbështetjes mjekësore.
- Ndihma në pajisjen me dokumente identifikimi.
- Sigurimi dhe lehtësimi i procesit arsimor.
- Vazhdimi i procedurave administrative dhe ligjore.
- Mbulimi i nevojave bazike jetësore.
- Mbështetja psikologjike dhe teologjike.
- Fuqizimi ekonomik i grave të kthyer.

Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm me qëllim ndërgjegjësimin e opinionit publik dhe aktorëve të vijës së parë të sektorëve të ndryshëm shtetërorë të institucioneve civile dhe atyre të sigurisë, të të rinjve, grave, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë relevantë të shoqërisë të përfshirë në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm raporton se ka kryer disa aktivitete në parandalimin dhe kundërshtimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, vlerësimi i të cilave mund të ofrojë një perspektivë mbi progresin dhe sfidat e kësaj fushe.

Në përmbushje të objektivit të Komunikimit Strategjik si një nga objektivat e Planit të Veprimit 2023-2025, QKEDH ka realizuar 33 publikime në faqen zyrtare të QKEDH, në rrjetet sociale Tëitter dhe në LinkedIn. Përcolli kontributin mbi draftin final *“Ri-integrimi në shkollë i fëmijëve të riatdhesuar nga Siria”* i cili do të publikohet në RTSH si artikull si dhe do të shfaqet në një kronikë të shkurtër në televizion. Gjithashtu, QKEDH përcolli komentet e saj mbi artikullin mediatik *“Demaskimi i keqinformimit fetar në Shqipëri”*.

Përgjatë periudhës raportuese, Drejtori i QKEDH ka kontribuar duke bërë një shkrim i cili është botuar në revistën *“Justice Trends”* mbi strategjitë e përdorura në burgje për të luftuar ekstremizmin si dhe përdorimi i qasjes rehabilituese në sistemin korrektues, duke lejuar një ndërveprim dinamik, mes përdorimit të metodave të forta dhe të buta, që përshtasin sigurinë me parimet e kohezionit social, duke pakësuar mundësitë e përsëritjes të veprave penale.

Në shtator të 2023 u publikua në një nga gazetat prestigjioze angleze *INDEPENDENT* intervista e bërë me stafin e QKEDH-së mbi zhvillimin e proceseve të ri-integrimit për personat e kthyer nga zonat e konfliktit Siri dhe Irak.

Në funksion të transparencës mbi aktivitetin e QKEDH-së përgjatë kësaj periudhe nëpërmjet AKSHI-it, u bë azhurnimi i *Programit të Transparencës* në faqen zyrtare të saj. QKEDH bëri plotësimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës në faqen zyrtare të qendrës sipas kërkesave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

QKEDH ka arritur të realizoj 4 artikuj mediatik mbi rehabilitimin dhe ri-integrimin e të kthyerve nga zonat e konfliktit Siri/Irak dhe qasjen e Parandalimit dhe Kundërshtimit të Ekstremizmit të Dhunshëm në kuadër të programit *“Ri-integrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria”*.

QKEDH dha kontributin e saj nëpërmjet një interviste në televizionin Klan Neës, gjatë së cilës u përcoll informacion mbi ndërhyrjet e realizuara përgjatë këtyre viteve nga Shteti Shqiptar për identifikimin, parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm, proceset e ri-integrimit të nënave dhe fëmijëve të rikthyer nga zonat e konfliktit, në shkollë dhe komunitet, si dhe sfidat e arritjet e paraqitura gjatë këtyre viteve.

QKEDH dha kontributin e saj nëpërmjet një interviste në Televizion Kombëtar Rumun *“Strile TV”* mbi proceset e Rehabilitim/ Riintegrimit dhe Risocializimit të shtetasve shqiptarë të riatdhesuar nga ish zonat e konflikti Siri-Irak, si dhe mbi situatën e personave të cilët ndodhen ende në këto zona.

QKEDH ka realizuar 3 spote ndërgjegjësuese nëpërmjet Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në kuadër të programit *“Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria”*. Spoti 1 nxjerr në pah Shqipërinë si një shtet laik që mbështet lirinë e shprehjes në besim, ku individët as nuk janë të detyruar dhe as të ndaluar të bashkohen me komunitetet fetare ose të praktikojnë bindjet e tyre publikisht. Ai thekson shembullin pozitiv të dhënë nga komunitetet fetare në Shqipëri, duke shfaqur mirëkuptimin, tolerancën dhe bashkëpunimin. Spoti 2 trajton sfidat e

dezinformimit dhe radikalizimit, veçanërisht duke synuar të rinjtë në Shqipëri. Ai thekson rëndësinë e luftimit të ekstremizmit të dhunshëm duke promovuar burime të besueshme, duke përfshirë udhëheqës fetarë të njohur. Spoti 3 ka patur në fokus ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e kundër-narrativave ndaj ekstremizmit të dhunshëm, mikpritjen e të kthyerve në komunitet dhe promovimin e një mjedisi fetar më të sigurt në komunitet.

Ka vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe ofrimi i këshillimit dhe suportit për individët në risk dhe familjarët e tyre që kanë nevojë për mbështetje apo informacion mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin përmes *Linjës Telefonike Kombëtare 0800 4545* me mbështetjen e organizatës Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza.

VI. MBROJTJA NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI

Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH) gjatë viti 2023 ka patur si objektiv, zhvillimin e politikës së sigurisë në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit për rritjen dhe garantimin e sigurisë publike në shkallë vendi, për ta përafuar me atë të standardeve evropiane, përmes rritjes së cilësisë profesionale të shërbimit, kapaciteteve njerëzore, teknike, infrastrukturore, etj. Si rezultat i rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe mjeteve logjistike, si dhe shpërndarjes së shërbimit në të gjithë territorin e vendit është rritur efektiviteti i ndërhyrjeve dhe është shkurtuar koha e reagimit duke parandaluar në këtë mënyrë dhjetra raste të përhapjes së zjarreve që mund të përbënin ngjarje me pasoja gjatë sezonit të verës.

Prioritetet kryesore dhe në fokus të veçantë gjatë vitit 2023 kanë qenë: përmirësimi i veprimtarisë operacionale dhe inspektuese, rritja e masave parandaluese kundër rrezikut ndaj zjarrit, nëpërmjet zbatimit të ligjshmërisë, detyrimeve ligjore, rritjes së edukimit dhe përgjegjshmërisë, kontrolleve të vazhdueshme, si dhe rritjes së vazhdueshme të nivelit tekniko-profesional të punonjësve të inspektim - parandalimit të shërbimit të MZSH-së, koordinimi i punës dhe bashkëpunimi ndërinstitucional, veçanërisht me Forcat e Armatosura, Policinë e Shtetit, Shërbimin e Ambulancës për të gjitha ngjarjet e veçanërisht për aksidentet rrugore, ku shërbimi zjarrfikës është faktori kryesor për shpëtimin e të aksidentuarve, bashkëpunimi me shërbimet zjarrfikëse homologe për zhvillimin e mëtejshëm të performancës dhe bashkëpunimit të ndërsjellët, sidomos me shërbimet zjarrfikëse të rajonit dhe jo vetëm, insistimi i vazhdueshëm pranë kryetareve të bashkive për përmirësimin e kompletimit të stacioneve zjarrfikëse me mjete dhe pajisje të nevojshme për shërbimin, si dhe të personelit zjarrfikës me uniforma të përditshme pune dhe hartimi i projektfishës IPA3 për digjitalizimin e shërbimit të MZSH-së në 12 bashkitë Qendër Qarku si dhe ngritjen e Qendrës Kombëtare të Trajnimit Zjarrfikës. Gjithashtu edhe përmirësimi në vlera i pagës bazë për gradë për punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, si dhe diferencimi në vlera të shtesës për natyrë të veçantë pune, sipas funksioneve korresponduese dhe strukturës së shërbimit qendror dhe vendor të MZSH-së.

Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar

Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit në kuadër të bashkëpunimit me institucione, organizma të tjera ndërkombëtare, shërbimet homologe, subjekte jopublike dhe organizata joqeveritare ka qenë e fokusuar në mbarëvajtjen e bashkëpunimit për realizimin e projekteve si më poshtë:

Pjesëmarrje në të gjitha aktivitetet e Komitetit Ndërminterial të transportit të mallrave të rrezikshme, mobilizues për rajonin, në kuadër të projektit TAIEX-it, si përfaqësues nga shërbimi zjarrfikës në rolin e anëtarit në këtë komitet.

Bashkëpunim me AKMC dhe ODC (Zyra e Bashkëpunimit të Mbrojtjes Amerikane), për evidentimin, vlerësimin dhe investimin në infrastrukturën dhe kapacitetet e shërbimeve zjarrfikëse

vendore ku u ra dakort për investime për ndërtimin e katër stacioneve zjarrfikëse, përkatësisht në bashkit: Prrenjës, Mat, Patos dhe Mirditë.

Bashkëpunim dhe pjesëmarrje me AKMC, në kuadër të modulit GFFF 2.2, për të mundësuar trajnimin parapërgatitor që do të zhvillohet më datë 26-29/02/2024 në Shqipëri dhe finalizimin me stërvitje komplekse më datë 18-22 mars 2024 në Maqedoninë e Veriut.

Angazhim në projekt-propozimin *“Dixhitalizimi i shërbimeve dhe ngritja e qendrës së trajnimit për forcat zjarrfikëse”*, referuar procesit të programimit të IPA Kombëtare për vitet 2023 - 2024.

Në kuadër të projektit UNDP *“Forcimi i kapaciteteve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit”* 2021 – 2023, shërbimi zjarrfikës ka qënë përfitues në 10 bashki. 169 uniforma zjarrfikëse PPE për bashkitë Fier, Kamëz, Krujë, Kurbin, Kavajë, Pogradec, Lezhë, Shijak.

Mbështetja me pajisje zjarrfikëse (3 automjete zjarrfikëse dhe 3 kontejnerë me të gjitha pajisjet e kërkim shpëtimit për bashkitë Durrës, Lezhë, Fier,). Ndërtimi i 2 stacioneve zjarrfikës të rinj në Fier dhe Pogradec. Trajnimi i 356 punonjësve të shërbimit të MZSH-së.

Në kuadër të projektit IPA CARE 2023-2027 *“Capacity for Risk Management of Earthquakes and Health Emergencies”* në bashkëpunim me AKMC, MZSH ka qënë pjesëmarrës në disa takime ndëristitucionale.

Ngritja e modulit GFF Ground Forest Fires në bashkëpunim me AKMC. Pjesëmarrje në takime dhe trajnime, ushtrime në tavolinë si dhe në komitetete drejtuese.

TAIEX mission *“Fire prevention capacity building in case of accidents during the transport of dangerous goods in Albania”*.

Takime të vazhdueshme në kuadër të komitetit të transportit të mallrave të rrezikshme.

Takime të ndryshme me AKMC në lidhje me projekte në fushën e mbrojtjes civile në Shqipëri.

Kualifikimi dhe përmirësimi i burimeve njerëzore të shërbimit zjarrfikës dhe shpëtimit përmes trajnimeve gjatë vitit 2023 ku përfituan rreth 159 punonjës të nivelit bazë dhe të mesëm të strukturave vendore si më poshtë:

- Organizimi dhe zhvillimi i 3 kurseve trajnimi 5 - ditore, për rreth 77 punonjës të shërbimeve vendore të MZSH-së të cilët u certifikuan për fitimin e gradës “Kryezjarrfikës”.
- Organizimi dhe zhvillimi i kursit të trajnimit një javor në 06/02/2023 – 10/02/2023, “Për fitimin e gradës “Inspektor zjarrfikës”, për 17 punonjësi të nivelit të mesëm në shërbimet vendore të MZSH-së.

- Organizimi dhe zhvillimi i kursit të trajnimit një javor për fitimin e gradës “Kryezjarrfikës” për 31 punonjës të bashkive të ndryshme të vendit.
- Organizimi dhe zhvillimi i kursit të trajnimit dy javor për 17 punonjës të nivelit bazë të marrë rishtazi në bashkitë e qarkut Tiranë, i cili u zhvillua një javë në AS dhe një javë në stacionin zjarrfikës “21 dhjetori”, Tiranë.
- Organizimi dhe zhvillimi i kursit të trajnimit dy javor për 29 punonjës të nivelit bazë të marrë rishatazi në bashkitë e qarkut Shkodër Kukës, Dibër dhe Lezhë, i cili u zhvillua një javë në AS dhe një javë në stacionin zjarrfikës të bashkisë Shkodër.
- Nëpërmjet UNDP, shoqata AFPRA, si pjesë e projektit SCAFPR, financuar nga Qeveria e Polonisë, nga data 15.11.2023 deri më datë 22.12.2023 u zhvilluan trajnime 5 ditore për punonjësit e shërbimeve zjarrfikëse të bashkive Pogradec, Durrës, Kavajë, Shijak, Tiranë, Devoll, Maliq, Gramsh, Përmet, Bulqizë, Finiq, Klos, Shkodër, Kurbin, Mirditë dhe Lezhë, ku në total morën pjesë 360 punonjës, prej të cilëve u certifikuan 324..

VII. PROGRAMET E VEÇANTA PËR FITIMIN E SHTETËSISË

Agjencia e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë është krijuar me VKM Nr. 1008, datë 25.11.2020 dhe ka filluar funksionalitetin në muajin maj 2021. Veprimtaria e saj edhe gjatë vitit 2023 është fokusuar kryesisht në krijimin e bazës së nevojshme ligjore për të plotësuar infrastrukturën e nevojshme, me qëllim vendosjen në funksion të programeve të veçanta për dhënien e shtetësisë Shqiptare..

Gjatë vitit 2023 janë hartuar dhe miratuar disa akte të rëndësishme lidhur me dhënien e shtetësisë për interes art, kulturë, arsim, shkencë, sport dhe kombëtar si më poshtë:


- *“Tarifa e shërbimit”* të Agjencisë miratuar me Udhëzimin e Përbashkët Nr. 45, datë 12.4.2023 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, publikuar në Fletoren zyrtare nr. 66 datë 19.04. 2023.
- VKM-ja Nr. 205, datë 6.4.2022 *“Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave të aplikimit, të rregullave të kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme për fitimin e shtetësisë shqiptare për kontribut të veçantë në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit”* është ndryshuar me VKM-në Nr. 478, datë 01.08.2023 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 205, datë 6.4.2022”*. Ky ndryshim rregullon kriteret teknike të detyrueshme për tu plotësuar nga shtetasi i huaj për të paraqitur kërkesë për fitimin e shtetësisë shqiptare si rezultat i kontributit të tij të veçantë në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit, dhe deregullimin e dokumentacionit të nevojshëm për tu paraqitur së bashku me kërkesën për fitimin e shtetësisë shqiptare duke u mbështetur në praktikën e punës si dhe hapat procedurale që ndiqen nga AHPVSH-ja për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për fitimin e shtetësisë shqiptare.
- Është përgatitur Projektvendimi *“Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave të kërkesës, të rregullave të kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme për fitimin e shtetësisë shqiptare kur Republika e Shqipërisë ka interes kombëtar apo interes në fushën e arsimit, shkencës, artit, kulturës dhe sportit”*, së bashku me relacionin përkatës. Ky Projektvendim synon ndryshimin e dy VKM-ve të mëparshme, VKM-së Nr. 205, datë 6.4.2022 në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 151, datë 11.3.2022 në fushën e artit dhe kulturës dhe përfshirjen e të gjitha programeve të veçanta në një VKM, në kuadër të derregullimit dhe unifikimit të procesit të paraqitjes së kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare duke pasur për qëllim hartimin e bazës ligjore rregulluese, përcaktimin e kriterëve, të procedurave të kërkesës, të rregullave të kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme për fitimin e shtetësisë shqiptare kur Republika e Shqipërisë ka interes kombëtar apo interes në fushën e arsimit, shkencës, artit, kulturës dhe sportit, dhe ky kontribut vlerësohet se përbën interes të veçantë për shtetin shqiptar.

VIII. PRITJA DHE TRAJTIMI I AZILKËRKUESVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Gjatë viti 2023, Qendra Pritëse për Azilkërkuesit ka pritur dhe akomoduar në total **256 azilkërkues**, nga të cilët 125 të rritur (58 femra dhe 67 meshkuj) dhe 131 të mitur (48 femra dhe 83 meshkuj), nga të cilët 130 të shoqëruar dhe 1 i pashoqëruar,


Numri i azilkërkuesve të akomoduar gjatë tre viteve të fundit ka ardhur duke u rritur. Konkretisht numri i azilkërkuesve të akomoduar në vitin 2021, ka qenë 78, në 2022 janë akomoduar vetëm 84 persona dhe në 2023 janë akomoduar 256 persona. Ajo që vihet re gjatë vitit 2023 është se numri më i lartë i azilkërkuesve është shënuar në muajin nëntor 2023 me 53 persona.

AZILKËRKUES TË AKOMODURA NË QENDËR




Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur situata e numrit të azilkërkuesve të akomoduar në qendër sipas muajve. Vihet re se fluski më i madh i azilkërkuesve të akomoduar në qendër ka qenë gjatë muajve mars, shtator dhe nëntor dhe numri më i ulët i të akomoduar në qendër është shënuar gjatë muajit dhjetor me asnjë rast.

NUMRI I AZILKËRKUESVE TË AKOMODUAR SIPAS MUAJVE



Numri i familjeve të cilat kanë kërkuar akomodim në qendër gjatë 2023 kanë qenë 52 në total dhe krahasuar me një vit më parë ky numër ka shënuar rritje me 30 familje më shumë, të cilat kanë kërkuar akomodim në qendër. Origjina e familje që kanë kërkuar akomodim sipas përqindjes është: 56% me origjinë nga Afganistani, 23% me origjinë nga Siria, 11% me origjinë nga Iraku, 8% me origjinë nga Somalia dhe 2% me origjinë nga Irani. Dymbëdhjetë prej azilkërkuesve të akomoduar, me kërkesën e tyre janë zhvendosur jashtë Qendrës me mbështetjen e UNHCR-së dhe RMSA-së për ndjekjen e procedurave përkatëse për azil.

FAMILJE SIPAS ORIGINËS TË AKOMODUARA NË QPA NË VITIN 2023



Bashkëpunimi me strukturat e Policisë së Shtetit dhe Bashkisë Kamëz ka qenë i vazhdueshëm, shumë efikas dhe i domosdoshëm për koordinimin e informacionit midis strukturave përkatëse, gjithashtu edhe bashkëpunimi me Drejtorinë e Politikave për Azilin të Huajt dhe Shtetësinë në Ministri, për problemet e statusit të azilkërkuesve. Gjatë vitit 2023 ka vijuar bashkëpunimi i suksesshëm me organizatat ndërkombëtare UNHCR, RMSA, ILO, Caritas Albania, GIZ, Qendra Ura. UNHCR dhe RMSA kanë mundur shërbimin mjekësor me një infermiere. Konkreisht gjatë kësaj periudhe këtë shërbim e kanë përfituar shumë azilkërkues. Infermierja ka ofruar shërbimin e parë dhe ka asistuar në shoqërimin e tyre në qendra të ndryshme shëndetësore dhe spitalore. Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2023 janë ofruar 1144 shërbime shëndetësore.

Për krijimin e një mjedisi sa më argëtues dhe relaksues për fëmijët, në Qendër ndodhet një dhomë posaçërisht për ta, e quajtur “Dhoma e fëmijëve”, ku punojësit e Sektorit të Mbështetjes së Azilkërkuesve kanë bërë të mundur shoqërimin e fëmijëve duke krijuar lojëra argëtuese dhe zhvilluese për ta. Gjithashtu, Qendra ofron edhe sallën e bibliotekës dhe internetit për tju siguruar azilkërkuesve një mundësi komunikimin me familjarët e tyre. Psikologjia e Qendrës ka qenë gjithmonë e pranishme dhe ka kryer vlerësime psikologjike me azilkërkuesit.

Në bashkëpunim me organizatat e lartëpërmendura janë zhvilluar takime informuese në qendër ndërmjet stakeholder-save të përfshirë në adresimin e nevojave të azilkërkuesve dhe shtetasve të akomoduar dhe janë organizuar disa aktivitete për edukimin dhe argëtimin e fëmijëve si më poshtë:

- Më datë 28.02.2023 azilkërkuesit e QPA-së vizituan ekspozitën “Në emër të lirisë” të Z. Rexhep Selimi pranë ambjenteve të COD në Kryeministri.
- Në kuadër të ditës ndërkombëtare të gruas “8 Mars”, në bashkëpunim me Caritas Dioqezan Tiranë-Durrës dhe RMSA u organizua një vizitë në kalanë e Krujës, muzeun kombëtar “Gjergj Kastriot Skënderbeu”, muzeun Etnografik, Teqen e Dollmës dhe në tregun tradicional.
- Në bashkëpunim me Caritas Dioqezan Tiranë-Durrës u organizua pedalimi nën thënien e Papa Françeskut “Të lirë për të zgjedhur nëse migrojmë apo qëndrojmë” me azilkërkuesit e Qendrës pranë liqenit të Tiranës.
- Në kuadër të festës së “1 qershori” u organizuan aktivitete argëtuese me fëmijët e akomoduar në Qendër.
- Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Refugjatëve më datë 20.06.2023 në bashkëpunim me RMSA dhe Caritas Dioqezan Tiranë-Durrës u organizuan aktivitete social-kulturore, sportive në Liqenin Artificial të Tiranës për të promovuar, kuptuar dhe respektuar larmishmërinë e komuniteteve të tyre.
- Në kuadër të festës së “1 qershori” u organizuan aktivitete argëtuese me fëmijët e akomoduar në Qendër.
- Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Refugjatëve më datë 20.06.2023 në bashkëpunim me RMSA dhe Caritas Dioqezan Tiranë-Durrës u organizuan aktivitete social-kulturore, sportive në Liqenin Artificial të Tiranës për të promovuar, kuptuar dhe respektuar larmishmërinë e komuniteteve të tyre.
- Gjatë muajit Korrik, u organizua Kampi Veror me fëmijët e Qendrës në bashkëpunim me Caritas Dioqezan Tiranë-Durrës ku u zhvilluan aktivitete të ndryshme sociale, zhvilluese, integruese, kulturore dhe argëtuese për fëmijët azilkërkues.
- Gjatë muajit Nëntor, në kuadër të “Festave Kombëtare të Pavarësisë dhe Flamurit” në bashkëpunim me RMSA u organizuan aktivitete social-kulturore në qytetin e Vlorës me azilkërkuesit e akomoduar në Qendër.
- Më datë 01.12.2023 në bashkëpunim me RMSA u mbajt një sesion trajnimi kundër dhunës me bazë gjinore, ku shtetasit e akomoduar patën mundësinë të njiheshin me legjislacionin në fuqi, mbrojtjen dhe shërbimet e ofruara në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu sëbashku me fëmijët u realizuan piktura ku nëpërmjet imagjinatës së tyre u pasqyrua pozicioni i nënës në familje, përkujdesja dhe dashuria e saj.
- Gjatë muajit Dhjetor, në kuadër të “Festave të Fundit të Vitit”, u organizuan aktivitete të ndryshme sociale në bashkëpunim me Caritas Dioqezan Tiranë-Durrës, TEK URA dhe RMSA.

Gjatë vitit 2023 Qendra Pritëse për Azil ka realizuar disa prioritete të cilat lidhem me përmirësimin e kushteve të saj dhe shërbimeve që ofron si më poshtë:


- ✓ Ndërtimi i murit rrethues të Qendrës së Pritjes për Azil për të rritur sigurinë dhe mirëqënien e jetës së kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare të cilët akomodohen në Qendër.
- ✓ Ndërtimi i fushës së futbollit dhe këndit të lojrave në Qendrën e Pritjes për Azil për të rritur cilësinë e jetesës së kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare të akomoduar si dhe për të mundësuar integrimin dhe socializimin e tyre.
- ✓ Përmbushja e objektivave me efektivitet në kuadër të ofrimit të shërbimeve sipas standardeve të duhura për kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare që akomodohen në Qendër, ka udhëhequr punën e përditshme të stafit ku është reflektuar në mungesa të problematikave të evidentuara përgjatë vitit që çënojnë integritetin, funksionimin dhe imazhin e përgjithshëm të institucionit.

IX. SHËRBIMET E SHTËPISË SË PUSHIMIT

Shtëpia e Pushimit Durrës që nga viti 2019 deri aktualisht po punon me kapacitet të reduktuar për shkak të dëmtimeve nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019 edhe gjatë vitit 2023 ka vijuar të punohet me 11.7% të kapacitetit akomodues duke shfrytëzuar maksimalisht mundësit për rritjen e të ardhurave. Gjatë kësaj periudhe klientela kryesore ka qenë klientë jashtë sistemit të Ministrisë së Brendshme, pasi vetëm 15 dhoma kanë qenë në efikasitet.

Krahasuar me vitin 2022, viti 2023 dëshmoj menaxhimin efikas të këtyre kapaciteteve duke rritur të ardhurat me 107.7% ose shprehur ndryshe + 831,946 lekë më shumë. Sipas strategjisë së ndjekur nga menaxhimi përveç aktivitetit kryesor, për shkak të mungesës së kapacitetit akomodues puna u fokusua në mbledhjen e të ardhurave duke shfrytëzuar edhe elemente të tjera në ambientet e Shtëpisë së Pushimit si: çadrat e plazhit, parking, biletë hyrje me qëllim futjen në efikasitet të njësive. Në fokus të punës ka qenë gjithashtu rritja e kënaqësisë së klientit përmes vënies në përdorim me efektivitet dhe efikasitet i të gjitha burimeve njerëzore dhe materiale. 98.5% e klientëve kanë vlerësuar pozitivisht shërbimet e marra në Shtëpinë e Pushimit gjatë vitit 2023.

Gjatë vitit 2023 **të ardhurat e krijuara janë në vlerën 16,342,749 lek, duke shënuar një rritje me 831,946 më shumë** se viti i kaluar.



Prioritet vazhdon të jetë riparimi i pasojave të tërmetit: rikonstruksioni i hotelit nr.2 me kapacitet 49 dhoma dhe 130 shtretër, rindërtimi i hotelit nr.1 dhe ndërtimi i një godine të re, në truallin e hotelit të shembur, sipas praktikave me standarte bashkëkohore duke përfshirë të gjitha shërbimet me ambiente konkurruese në treg. Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit në të gjitha nivelet për të siguruar një shërbim efektiv, eficient dhe ekonomik për të menaxhuar burimet dhe motivuar punonjësit në kryerjen e detyrave. Forcimi i bashkëpunimit me organet që janë objekt i veprimtarisë së këtij shërbimi dhe punonjësit e tyre; organet e agjencitë e tjera publike dhe ato homologe të rajonit e më gjerë për të marrë eksperiencat më të mira. Sigurimi i burimeve të duhura (njerëzore, materiale e teknologjike), për të krijuar kushtet e nevojshme dhe motivuar punonjësit në kryerjen e detyrave.

REFERENCA

1. Ligji nr. 90/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”* dhe plani i punës vitit 2023.
2. Analiza vjetore e Policisë së Shtetit dhe statistikat zyrtare krahasuese 2022-2023.
3. Analiza vjetore e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
4. Analiza vjetore e Gardës së Republikës së Shqipërisë.
5. Analiza vjetore e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.
6. Analiza vjetore e Qendrës Kombëtare Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.
7. Analiza vjetore e Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.
8. Analiza vjetore e Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë.
9. Analiza vjetore e Qendrës Pritëse për Azilkërkuesit.
10. Analiza vjetore e Shtëpisë së Pushimit Durrës.